



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3. par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2005 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS
RAJONALE PËR AFTËSIMIN PROFESIONAL NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Rajonale për Aftësimin Profesional, në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, nga neni 1 i këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr.2903/1 Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht prej 1.06.00 ha, në tërësi sipas situacionit grafik i cili paraqet pjesë përbëse të këtij Vendimi.

Neni 3

Lokacioni i caktuar sipas këtij Vendimi gjendet në kuadër të kufijve të planit rregullativ të lagjes “Kalabria” në Prishtinë.

Neni 4

Ky Vendim paraqetë bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejeimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ditën e miratimit të këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, shfuqizohet Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit mbi caktimin e lokacionit me destinim për ndërtimin e objektit të gjimnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë, nr. 01-353-1724, dt. 06.10.2003.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.353-658, më 29.12.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri